



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.444/9 prot.

Datë 25.02.2026

V E N D I M
Nr. 308/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “Shendelli” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-71516-12-10-2025, me objekt “*Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh*” me fond limit **121.568.820,86** (njëqind e njëzetë e njëmilion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e njëzetë prese tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakaster.

Ankimues:

OE “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N dhe me adresë Lagjia Kastrioti ,rruga Andon Profka ,2 kullat Fier, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Mallakaster me adresë Lagjia “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.12.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedura e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-71516-12-10-2025, me objekt “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh” me fond limit **121.568.820,86** (njëqind e njëzetë e njëmilion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e njëzetë prese tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakaster.

II.2. Në datën, 12.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 28.01.2026 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Inerti” sh.p.k & “ZDRAVA” shpk	82 929 177,58	I skualifikuar
2. OE “Shendelli” shpk	94 449 717	I skualifikuar
3. OE “C O L O M B O” Shpk	111 540 387	I kualifikuar
4. OE “Zeqillari” Sh.p.k	119 863 707	I skualifikuar
5. OE “Britania” Sh.p.k	121 212 665	I skualifikuar
6. OE “Lacaj” Shpk	121 568 800	I skualifikuar

II.4. Në datën 10.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 14, datë 16.02.2026, ku është shpallur fitues OE “C O L O M B O” shpk.

II.5. Në datën 11.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 444/2026 protokoli, datë 11.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6316 e OE “Shendelli” Shpk, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “Shendell” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.444/1 prot, datë 12.02.2026, lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “Shëndelli” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se statusi i pagesës për ankesën me numër 444/2026 datë 11.02.2026 rezulton **“Paparaqitur mandat pagesë”**. Me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP me shkresën nr. 444/2 prot., datë 16.02.2026 nga KPP ju kërkua informacion autoritetit kontraktor për sa më poshtë vijon:... me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon të informohet në lidhje me administrimin e kësaj ankese pranë institucionit tuaj si dhe veprimet proceduriale të kryera nga ana juaj sipas parashikimeve të nenit 111/3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 94/4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e të metave të ankesës...”.

II.8. Me shkresën me nr. 5891/23 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 444/3 prot., datë 18.02.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion me shërbim postar, duke i kërkuar operatorit ekonomik ankimues shkresën me objekt “Njoftim për plotësimin e ankesës” dhe për dijeni KPP-së.

II.9. Nëpërmjet komunikimit të sistemit elektronik të ankesave, me shkresën nr. 5891/26 prot., datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.444/4 prot., datë 19.02.2026, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e OE “Shëndelli” Shpk dhe në përfundim **ka vendosur refuzimin e saj**, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku ndër të tjera argumenton se: “[...].....

Gjatë shqyrtimit të ankesës, KSHA, vëren:

Ankimuesi, OE “Shëndelli” shpk me NIPT K07924803N, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe nga verifikimi i kryer nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës

rezulton se ankimuesi në formularin standard të ankesës nuk ka bashkëlidhur dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës sipas përcaktimeve ligjore (fatura e papaguar).

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 111, pika 3 e Ligjit me nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar e cila përcakton se “Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur”.

Komisioni i shqyrtimit të Ankesës me anë të shkresës me nr. 5891 Prot., datë 16.02.2026 “Njoftimi mbi plotësimin e të metave”, i është drejtuar subjektit ankues në lidhje me paraqitjen e dokumentit i cili vërteton pagesën e tarifës brenda 2 (dy) ditëve nga momenti i marrjes së njoftimit, në mënyrë që ankesa të shqyrtohet nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës pranë AK, Bashkia Mallakastër.

Ky dokument nuk rezulton të jetë paraqitur nga ana e subjektit ankues.

Përfundimisht, bazuar në nenin 114 të Ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik, datë 23.12.2020, si dhe në përcaktimet e bëra në nenin 102 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

VENDOSI

1. Të mos pranojë ankesën e Operatorit Ekonomik “Shëndelli” shpk me NIPT K07924803N, për procedurën e prokurimit publik “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me numër reference REF – 71516-12-10-2025, me objekt “Rikonstruksioni i shkollës 9 – Vjecare Ismail Klosi Ballsh”, me fond limit 121.568.820.86 (njëqind e njëzetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzetë, tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH lekë, zhvilluar në datën 12.01.2026 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 102 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, të vihet në dijeni për vendimin e marrë Komisioni i Prokurimit Publik dhe ankuesi, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESËS

II.10. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 5891/27 prot., datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.444/5 prot., datë 23.02.2026, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e OE “Shëndelli” Shpk dhe në përfundim **ka vendosur refuzimin e saj**, (Vendimi i KSHA me nr. 5891/26 prot., datë 19.02.2026), për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues.

II.11. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën me nr. 5891/25 prot., datë 18.02.2026, me objekt “Kthim përgjigjeje shkresës tuaj nr.444/2 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 444/6 prot., datë 23.02.2026.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 11.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 444/2026 protokolli, datë 11.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6316 e OE “Shëndelli” shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se OE ankimues “Shëndelli” Shpk nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”


III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Me shkresën me nr. 5891/23 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 444/3 prot., datë 18.02.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion me shërbim postar, duke i kërkuar operatorit ekonomik ankimues shkresën me objekt “Njoftim për plotësimin e ankesës” dhe për dijeni KPP-së.

III.1.3. Nëpërmjet komunikimit të sistemit elektronik të ankesave, me shkresën nr. 5891/26 prot., datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.444/4 prot., datë 19.02.2026, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e OE “Shëndelli” Shpk dhe në përfundim **ka vendosur refuzimin e saj**, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues, ku ndër të tjera argumenton se: “[...].....

Gjatë shqyrtimit të ankesës, KSHA, vëren:

Ankimuesi, OE “Shëndelli” shpk me NIPT K07924803N, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe nga verifikimi i kryer nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës



III.1.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP përmes shkresës me nr. 5891/23 prot., datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 444/3 prot., datë 18.02.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar informacion me shërbim postar, duke i kërkuar operatorit ekonomik ankimues shkresën me objekt “Njoftim për plotësimin e ankesës” dhe për dijeni KPP-së, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit i ka kërkuar OE “Shëndelli” Shpk, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit ka njoftuar (më datë 16.02.2026) operatorin ekonomik ankimues përmes komunikimit elektronik, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës.

Gjithashtu, me shkresën përcjellëse me nr. 5891/27 prot., datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr.444/5 prot., datë 23.02.2026, autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik se ka trajtuar ankesën e OE “Shëndelli” Shpk dhe në përfundim **ka vendosur refuzimin e saj**, (Vendimi i KSHA me nr. 5891/26 prot., datë 19.02.2026), për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues.

Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës, **rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga OE “Shëndelli” Shpk, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-71516-12-10-2025, me objekt “Rikonstruktion i Shkollës 9-Vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh” me fond limit **121.568.820,86** (njëqind e njëzetë e njëmilion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzetë prese tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakaster.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

